


Problema me 3 pikë

1. Në figurë janë dhënë 3 shigjeta fluturuese dhe 9 tullumbace të fiksuar. Kur një shigjetë godet një tullumbace, kjo e fundit pëllcet dhe shigjeta vazhdon rrugën në të njëjtin drejtim. Sa tullumbace do të pëllcasin shigjetat?



(A) 3


(B) 2

(C) 6


(D) 5

(E) 4


2. Mbi një tavolinë janë vendosur tre objekte si në figurë.




Cila është pamje që i shfaqet Pjetri nëse e shikon tavolinën nga sipër?




(A)




(B)



(C)




(D)



(E)

3. Diana çdo herë gjuan 2 shigjeta mbi tabelë. Herën e parë ajo fitoi 14 pikë, kurse herën e dytë 16 pikë. Sa pikë fitoi Diana herën e tretë?



14 pike

12 pike

???

(A) 17


(B) 18

(C) 19

(D) 20

(E) 22

4. Një kopsht është ndarë në katrorë të barabartë. Dy kërmij, njëri i shpejtë dhe tjetri i ngadaltë, lëvizin përgjatë perimetrit të kopshtit duke filluar nga kulmi S , por në drejtime të ndryshme, siç tregohet në figurën e mëposhtme. Kërmilli i ngadaltë lëviz me shpejtësi 1 metër në orë (1 m/h), ndërsa kërmilli tjetër me shpejtësi 2 metra në orë (2 m/h). Në cilën pikë do të takohen dy kërmijtë?



(A) A

(B) B

(C) C

(D) D

(E) E

5. Luiza zbriti dy numra 2-shifrorë. Pastaj mbuloi me ngjyrë dy prej shifrave, duke i fshehur ato. Cila është shuma e dy shifrave të ngjyrosura?



(A) 8


(B) 9

(C) 12

(D) 13

(E) 15

6. Një yll u formua nga katër trekëndësha barabrinjës dhe një katror. Perimetri i katrorit ishte 36 cm. Sa ishte perimetri i yllit?



(A) 144 cm


(B) 120 cm

(C) 104 cm

(D) 90 cm

(E) 72 cm

7. Figura e mëposhtme tregon kalendarin e një muaji të caktuar. Për fat të keq, mbi të është derdhur bojë, e cila ka mbuluar shumicën e datave. Në cilën ditë të javës bie data 25 e atij muaji?




- (A) E hënë (B) E mërkurë (C) E enjte (D) E shtunë (E) E dielë

8. Sa është numri më i vogël i herëve që duhet hedhur një zar i rregullt (me 6 faqe) për t'u siguruar që do të përsëritet të paktën një rezultat?


- (A) 5 (B) 6 (C) 7 (D) 12
(E) 18

9. Në figurën e mëposhtme jepen 3 katrorë. Katrori më i vogël i ka brinjët me gjatësi 6 cm. Sa është gjatësia e brinjëve të katrorit më të madh?



- (A) 8 (B) 10 (C) 12 (D) 14 (E) 16

10. Në figurën e mëposhtme, rrathët paraqesin llamba, të lidhura me disa nga llambat e tjera.




Fillimisht, të gjitha llambat ishin të fikura. Nëse preket një llambë, ajo ndizet së bashku me fqinjët e saj. Sa është numri më i vogël i llambave që duhet të prekim në mënyrë që të ndizen të gjitha llambat?

- (A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6

Problema me 4 pikë

11. Në cilin nga katër katrorët e mëposhtëm përqindja që zë zona me ngjyrë të zezë është më e madhe?



(A) A


(B) B

(C) C


(D) D

(E) % është e njëjtë në të katër katrorët


12. Nëntë makina mbërrijnë në kryqëzim dhe lëvizin sipas shigjetave që tregohen në figurë.



Cila nga figurat e mëposhtme tregon ato makina pasi kanë kaluar kryqëzimin?




13. Poshtë secilës prej figurave është vendosur njëri nga numrat 1, 2, 4 ose 5, në mënyrë që veprimet të cilat kryhen sipas drejtimit të dy shigjetave të jenë të sakta. Cili është numri poshtë figurës me yllin me 6 cepa?



- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

14. Një luan ndodhet pas njërës nga 3 dyert që tregohen në figurën e mëposhtme. Secila derë ka të varur mbi të një shënim, por vetëm njëri prej tyre është i vërtetë (saktë).



dera 1 dera 2 dera 3


Pas cilës derë ndodhet luani?

- (A) Pas derës 1. (B) Pas derës 2. (C) Pas derës 3.
 (D) Ka mundësi pas të tre dyerve (E) Ka mundësi pas të dy dyerve 1 dhe 2.

15. Dy vajza, Eva dhe Ollga dhe tre djem, Ademi, Isaku dhe Albani luajnë me një top. Kur topin e ka njëra nga vajzat, ajo e hedh atë ose tek vajza tjetër ose tek njëri nga djemtë. Kur topin e ka njëri nga djemtë, ai e hedh atë te një djalë tjetër, por jo te djali nga i cili sapo e mori topin. Loja filloi me Evën, e cila ia hodhi topin Ademit. Kush do të bëjë hedhjen e pestë të topit?

- (A) Ademi (B) Eva (C) Isaku (D) Ollga (E) Albani

16. Emili do të vendosë një numër në çdo trekëndësh të vogël të trekëndëshit të madh. Shuma e numrave në çdo dy trekëndësha të vegjël me baza të përbashkëta duhet të jetë e njëjtë. Ajo ka vendosur tashmë dy numra (siç tregohet në figurën e mëposhtme). Sa është shuma e të gjithë numrave në trekëndësh?




- (A) 18 (B) 20 (C) 21 (D) 22
 (E) nuk mund të përcaktohet

17. Të hënën Shqipja u shpërndau 5 shokëve një fotografi. Ata që marin fotografi, ia dërgojnë atë të nesërmen dy miqve që nuk e kanë parë akoma fotografinë. Në cilën ditë të javës numri i njerëzve

që kanë parë fotografinë bëhet më i madh se 100?

- (A) Të mërkurën (B) Të enjten (C) Të premten (D) Të shtunën (E) Të dielën

18. Faqet e një kubi janë ngjyrosur me ngjyrë të zezë, të bardhë ose gri, në mënyrë që faqet e kundërta të kenë ngjyra të ndryshme. Cila nga 5 hapjet e mëposhtme të kubit nuk është e mundshme?




19. Shpëtimi bën një mbledhje duke përdorur si shifra numrat A, B, C dhe D . Cili është numri që paraqet shifra B ?


$$\begin{array}{r} ABC \\ + CBA \\ \hline DDDD \end{array}$$

- (A) 0 (B) 2 (C) 4 (D) 5 (E) 6

20. Katër grabitës ndodhen në qeli të ndryshme të një burgu me 4×4 qeli, si në figurë. Njëri prej tyre po flen dhe nuk lëviz. Sa herë që fishkëllehet, 3 grabitësit e tjerë lëvizin në një qeli të lirë fqinje. Ata mund të lëvizin lart, poshtë, djathtas ose majtas, por atyre nuk u lejohej të kthehen në qelinë nga e cila sapo kanë ardhur. Katër figurat e mëposhtme tregojnë pamjet pas secilës prej 4 fishkëllimave.



Cili nga figurat e mëposhtme tregon rezultatin pas fishkëllimës së pestë?




Problema me 5 pikë

21. Nga lista e numrave 3, 5, 2, 6, 1, 4, 7 Mira zgjodhi 3 prej tyre, që shumën e kishin 8. Nga të njëjtat numra Diana zgjodhi 3 numra, shuma e të cilëve ishte 7. Sa numra të përbashkët kanë zgjedhur Mira dhe Diana?

- (A) Anjë (B) 1 (C) 2 (D) 3
(E) Nuk përcaktohet dot

22. Pesë gurë A, B, C, D, E peshojnë (jo përkatësisht) 30 g, 50 g, 50 g, 50 g dhe 80 g.



Duke parë figurën e mësipërme, gjeni se cili është guri që peshon 30 g?

- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E

23. Nëse A, B, C janë shifra të ndryshme, atëherë numri më i madh i mundshëm me 6 shifra i shkruar duke përdorur 3 shifra A, 2 shifra B dhe 1 shifër C nuk mund të jetë i barabartë me

- (A) AAABBC (B) CAAABB (C) BBAAAC (D) AAABCB (E) AAACBB


24. Shuma e moshave të Ketit dhe mamasë së saj është 36 dhe shuma e moshave të mamasë së saj dhe gjyshes së saj është 81. Sa vjeçe ishte gjyshja kur lindi Keti?

- (A) 28 (B) 38 (C) 45 (D) 53 (E) 56

25. Besniku dëshiron të ndajë numrat 2, 3, 4, ..., 10 në disa grupe në mënyrë të tillë që shuma e numrave në çdo grup të jetë e njëjtë. Sa është numri më i madh i grupeve që mund të formojë ai?


- (A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 6 (E) tjetër

26. Dritani copëtoi një dërrasë drejtkëndëshe me gjerësi 8 cm në 9 pjesë, ku njëra prej tyre ishte katror, ndërsa të tjerat ishin drejtkëndësha. Ai i vendosi të gjitha pjesët së bashku, siç tregohet në figurën e mëposhtme. Sa ishte gjatësia e dërrasës?




- (A) 150 cm (B) 168 cm (C) 196 cm (D) 200 cm (E) 232 cm

27. Në secilën kuti të tabelës së mëposhtme 5×5 shkruajmë 0 ose 1 në mënyrë që çdo katror me përmasa 2×2 të përmbajë saktësisht 3 numra të barabartë. Sa është shuma më e madhe e mundshme e të gjithë numrave në tabelë?



- (A) 22 (B) 21 (C) 20 (D) 19 (E) 18

28. Në një tavolinë të rrumbullakët janë ulur 14 persona. Çdo person është ose gënjeshtar ose i singertë. Secili prej tyre thotë: “Të dy fqinjët e mi janë gënjeshtarë”.



Sa mund të jetë numri më i madh i gënjeshtarëve të ulur në tavolinë?

- (A) 7 (B) 8 (C) 9 (D) 10 (E) 14

29. Në tryezë ndodhen tetë domino (figura majtas). Gjysma e njërës prej tyre është mbuluar nga një tjetër domino dhe nuk i shihen pikët.




Fig. 1





Fig. 2

Ato duhet të vendosen në një tabelë 4×4 (figura djathtas), në mënyrë që numri i pikave në çdo rresht dhe shtyllë të jetë i njëjtë. Sa pikë janë në pjesën e mbuluar të dominosë?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

30. Ardiani shkruan shtatë numrat 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 në shtatë rrrathë në mënyrë të tillë që shumat e tre numrave, të vendosura në rrrathë, sipas drejtimit që përmban rrethin e shënuar me “?” të jenë të barabarta. Sa është shuma e numrave në njërin nga këto drejtime?



- (A) 3 (B) 6 (C) 9 (D) 12 (E) 18